

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
ZYRA E NOTERISË

NR. 2112 Rep.

NR. 967/p Kol.

TAKSA E PULLES

U

**KONTRATË KONCESIONI  
E FORMËS "BOT" (NDËRTIM – OPERIM - TRANSFERIM) PËR  
NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT "BUSHTRICA 3"**

Në Ministrinë e Infrastrukturas dhe Energjisë, më datë 28, muaji Shkator, viti 2017 (dy mijeeshtatembëdhjetë), para meje noter Skënder Veçanta anëtar i dhomës së Noterisë Waw, me adresë \_\_\_\_\_, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, që më poshtë do të quhet "**AUTORITET KONTRAKTUES**", përfaqësuar me autorizimin nr.4752/5, date 13.9.2017 të Ministrit, nga Drejtoresha e Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit Znj. Etleva Kondi, shtetase shqiptare, e datëlindjes \_\_\_\_\_, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova nga

**DHE**

**Subjekti për Qëllime të Veçanta, shoqëria "Bushtrica Hydropower" sh.p.k.**, e krijuar nga Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik shoqëritë "ENOLIO" Sh.p.k., "EL-BU 2009" Sh.p.k., dhe "VEGA" Sh.p.k. i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, që më poshtë do të quhet "**KONCESIONARI**" e cili figuron e regjistruar si person juridik ne QKB me NUIS L72120013S, date 20.9.2017 regjistrimi, me seli ne adresën: Njesia administrative Nr.1, Rruga "Niko Avrami", Pasuria N 1/434+2-N, ZK 8120, Tirane, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë Z. Endrit Shabani, shtetase shqiptar, \_\_\_\_\_, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit ID me Nr. Personal \_\_\_\_\_

**Hyrje**

Duke patur parasysh se:

**Qeveria e Shqipërisë:**

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistues me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar.
2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë.
3. Vlerëson formën "BOT" të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur nxitjen e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat.

4. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit.
5. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.

#### **Koncesionari:**

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe operimin e hidrocentralit të sipërpërmendur dhe në përfundim të procedurës për zgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
2. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit “Bushtrica 3” në pellgun ujëmbledhës të lumit të Bushtricës, në Bashkinë Librazhd, Qarku Elbasan, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës.
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiarë, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektit të kësaj kontrate.
4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Ligjin nr. 125/2013 “Per koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575 datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension/partneritet publik privat”, i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.504, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ” duke rënë dakord për sa më poshtë:

#### **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Përkufizime dhe interpretime**

- 1.1.Kudo që në këtë Kontratë përdoren termat e mëposhtme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon. Termat e tjerë që mund të përkufizohen diku tjetër në këtë Kontratë Koncesioni do të kenë kuptimet që parashikohen në nenet apo anekset përkatëse të kësaj Kontrate Koncesioni.
  - 1) **Kontrata e Koncesionit:** Kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
  - 2) **Ligji “Për Koncesionet”:** Ligji nr.125/2013 “Per Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” i ndryshuar. Çështjet e kontratës që nuk rregullohen me këtë ligj, janë subjekt i dispozitave të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994. “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
  - 3) **Autoriteti Kontraktues:** Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë.

- 16) **Subjekti i furnizimit me energji elektrike:** Shoqëria e licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit ekzistues shqiptar.
- 17) **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme ose në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari, sipas Nenit 14.
- 18) **Enti Rregullator i Energjisë (ERE):** Është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".
- 19) **Aneks:** Çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate dhe/ose çdo leje, licence, kontrate ose dokument tjetër lëshuar nga autoritete shtetërore që shërbejnë në ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, janë pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.
- 20) **Instrument Financiar:** Nënkupton çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguruese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e objektit të këtij koncesioni, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
- 21) **Pala Financuese:** Nënkupton institucionet financiare të licencuara si të tilla, pa përjashtuar entin privat, që do të ndihmojë Koncesionarin në financimin e objektit të koncesionit.
- 22) **"E Drejta për Kalim"** do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, dhe në çdo pjesë të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj kontrate.
- 23) **"Shesh"** do të thotë sheshi që gjendet në gjurmen e kalimit të objekteve dhe nenobjekteve në rrjedhën e pellgut ujëmbledhës të lumit të Bushtrices, në përputhje me termit e referencës të përcaktuara në Dokumentat Standarde.
- 24) **"Gëzim i qetë"** do të thotë e drejta ekskluzive për të përdorur dhe gëzuar Sheshin (duke përfshirë Objektet Ekzistuese) dhe të Drejtën për Kalim gjatë Periudhës së Koncesionit, në përputhje me këtë Kontratë, pa ndërhyrje të pajustificuara nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë subjekt shtetëror.

## 1.2. Interpretimi

Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:

- 1) Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- 2) Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjansë;
- 3) Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull", të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
- 4) Titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Anekset dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi në interpretimin e kësaj Kontrate;
- 5) Referimet në dispozitat dhe Anekset janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate.
- 6) Pa paragjykim ndaj paragrafit të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet dispozitave dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojcë të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:

- 4) **Koncesionari:** Shoqëria “**Bushtrica Hydropower**” sh.p.k. e krijuar nga Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik shoqëritë “ENOLIO” Sh.p.k., “EL-BU 2009” Sh.p.k., dhe “VEGA” Sh.p.k., i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm e cila figuron e regjistruar si person juridik ne QKB me NUIS L72120013S, date 20.9.2017 regjistrimi, me seli ne adresën: Njesia administrative Nr.1, Rruga “Niko Avrami”, Pasuria Nr.7/434+2-N, ZK 8120, Tirane.
- 5) **Hidrocentrali/et:** Hidrocentrali “Bushtrica 3”, me vendndodhje në pellgun ujembledhes te lumit te Bushtrices, ne Qarkun Elbasan, me fuqi të përgjithshme të instaluar 6,700 (gjashtë mijë e shtatëqind) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 28 168 538 (njëzetetë milion e njëqindgjashtedhjetetë mijë e pesëqind e tridhjetetë) kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve sipas shfrytëzimit hidrologjik të pellgut ujembledhës të lumit të Bushtricës nga kuota 815 m m.n.d deri në kuoten 595 m m.n.d., përfshirë tërësinë e objekteve hidrologjike të saj që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprat e marrjeve, kanalën e devijimit, bazenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të sipas skemës së shfrytëzimit të kaskadës të optimizuar.
- 6) **Objekti:** Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, shfrytëzimi, mirëmbajtja e hidrocentralit dhe mundësia e transferimit të tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- 7) **Investimi:** Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe pajisjen me makineritë e nevojshme të hidrocentralit “Bushtrica 3”.
- 8) **Punimet:** Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit “Bushtrica 3”, në përputhje me projektin e zbatimit .
- 9) **Fillimi i punimeve:** Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8 pika 1 të kësaj kontrate.
- 10) **Vënia në punë e hidrocentralit:** Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe testimi sipas nenit 11 të kësaj kontrate.
- 11) **Kontratat:** Të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt shfrytëzimin, operimin e hidrocentralit dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.
- 12) **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatës publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin ekzistues në fuqi.
- 13) **Operimi:** Të gjitha veprimet e koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.
- 14) **Tarifa koncesionare:** është kompensimi monetar që paguan në formën e energjisë koncesionari për koncesionin, në vlerën dhe mënyrën e përcaktuar sipas nenit 16 të kësaj kontrate.
- 15) **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

1. Kërkesat e Autoritetit Kontraktues në procedurën konkurruese;
2. Oferta e Koncesionarit;
3. Dispozitat e kësaj kontrate;
4. Çdo Aneks tjetër dhe shtojcat e tyre;
5. Çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontratë ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontratë.



## **Neni 2 Objekti i Koncesionit**

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues në bazë të ligjit “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, i jep Koncesionarit me koncesion të formës BOT (që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së koncesionit):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit “Bushtrica 3” dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

## **Neni 3 Karakteristikat e hidrocentralit**

Hidrocentrali “Bushtrica 3” do të shfrytëzojë potencialin hidroenergjetik të pellgut ujëmbledhës të lumit të Bushtricës. Hidrocentrali “Bushtrica 3” parashikohet të jetë i tipit me derivacion dhe do të ketë parametrat kryesorë hidroenergjetikë si më poshtë vijon:

### Hidrocentrali “Bushtrica 3”

- Kuotat e veprave
  - Kuota e veprës së marrjes nr.1 (lumi Bushtrice) 815.0 m m.n.d.
  - Kuota e vepres së marrjes nr.2 (pr.Govates,dege) 815.0 m m.n.d.
  - Kuota e godinës së centralit (aksi i turbinave) 595.0 m m.n.d
- Fuqia e instaluar (kW) - N = 6700kW
- Energjia mesatare vjetore kWh - E = 28 168 538kWh/vit

Projekti mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve në variantin përfundimtar të projektzbatimit, i cili mund të përmirësohet por duke ruajtur të pandryshuar kuotat ekstreme dhe termat e përcaktuara në këtë kontrate.

## **Neni 4 Periudha e Koncesionit**

- 4.1.Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 (tridhjetepesë) vjetësh që fillon nga Data e hyrjes në fuqi të Kontratës dhe mbaron në ditën e përvjetorit të 35-të të hyrjes në fuqi të saj. Megjithatë, në rastin e Zgjidhjes përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data e hyrjes në fuqi të Kontratës dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes së saj.

<  
/



#### 4.2. Rastet e shtyrjes së Periudhës së Koncesionit:

4.2.1. Palët bien dakord se për shkaqe që ndikojnë drejt-përdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Koncesionari) ku përfshihet vetëm Forca Madhore periudha e koncesionit do të shtyhet, në përputhje me kohën e duhur që projekti të konsiderohet si rentabël dhe financiarisht i përshtatshëm në përputhje me analizat financiare të “Vlerës për Para”, “IRR” apo çdo lloj analize tjetër të përshtatshme për vlerësime të tilla.

4.2.2. Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit do të shtyhet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur Ngjarja dhe kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara.

#### 4.3. Zgjatja e Periudhës së Koncesionit

Palët bien dakord që, në përfundim të periudhës së koncesionit, afati i kësaj kontrate mund të zgjatet nëse është e nevojshme, për shkak të ndryshimeve të kontratës, siç parashikohet në nenet 31, 32 dhe 33, të ligjit Nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar.

## KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

### Neni 5 Të drejtat koncesionare - Sheshi

#### 5.1. Dhënia e të Drejtave Koncesionare

Që në Datën e Hyrjes në Fuqi të Kontratës, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili i pranon të drejtat për të gjithë Afatin e Kontratës:

- ii. të projektojë, financojë, ndërtojë, testojë, të ketë në pronësi, të operojë, shfrytëzojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralin;
- iii. në varësi të Nenit 5.2 më poshtë, të ketë Gëzim të Qetë;
- iv. me mbarimin e Afatit t’i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t’i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentralit dhe të Objekteve Ekzistuese të shtuara, nëse ka; si dhe, në çdo rast, t’i kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjydhmërisht të lidhura me këto aktivitete (së bashku, “**të Drejtat Koncesionare**”).
- v. Koncesionari do të ketë të drejtën ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet nga Projekti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në çertifikatat CER.

#### 5.2. Dhënia e Sheshit

**5.2.1.** Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 5.1 të këtij neni, Sheshi, e Drejta për Kalim, Gëzimi i Qetë do të konsiderohen se i jepen koncesionarit vetëm pasi Koncesionari të pajisë Autoritetin Kontraktues me kopje autentike të çertifikatave siguroese që vërtetojnë (në një masë të arsyeshme të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues), se Koncesionari është pajisur me policat e sigurimit dhe garancitë e kërkuara për këtë

- 5.2.2. Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës për Kalim, Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujën e pellgut ujëmbledhës të lumit të Bushtricës, Koncesionari e pranon Sheshin “siç është” që nga data e një dhënieje të tillë, si dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të kryejë ndonjë shpenzim, as nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë Pretendim përkundrejt Koncesionarit, në lidhje me gjendjen e Sheshit.
- 5.2.3. Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë këtë të fundit në marrëdhëniet me të tretët, në mënyrë që të shmanget çdo pengesë, që mund të haset në kuadër të shpronësimeve apo çdo lloji tjetër pengese, në lidhje me servitutet dhe uzufruktet përkatëse, për t’i siguruar koncesionarit një gëzim të qetë të sheshit, për realizimin e punimeve dhe operimin normal për realizimin e kësaj vepre. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm, kur moszgjidhja e pengesave të mësipërme, vjen si rezultat i mos përmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse, për shkak të veprimeve të fajshme të Koncesionarit.
- 5.2.4. Në rast kur sheshi është pronë shtetërore Koncesionari i drejtohet institucionit përkatës që ka në administrim/pronësi sheshin pronë shtetërore për lidhjen e një kontrate përdorimi tip uzufrukt në përputhje me ligjin.

## Neni 6

### Monitorimi dhe Mbikëqyrja e Përgjithshme

#### 6.1. Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë monitorim në çdo kohë, në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosëkzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate. Rezultatet e monitorimit do t’i bëhen të njohura Koncesionarit, me shkrim.

#### 6.2. Mbikëqyrja e përgjithshme e punimeve

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë periudhës së koncesionit të mbikëqyrë zbatimin e punimeve të ndertimit gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.


Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë monitorimit dhe mbikëqyrjes së përgjithshme, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t’i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

## Neni 7

### Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- 1) Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar.

- 
- 2) Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj vepre. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licensë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospërbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.
  - 3) Të miratojë projektin e Zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës. (ose të ndryshuar me marrëveshje të dy palëve)
  - 4) Të ndihmojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektit të kësaj kontrate.
  - 5) Të garantojë Koncesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e projektit të Koncesionarit.
  - 6) Të garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nese Koncesionari ploteson kushtet e percaktuara në nenin 22 të Ligjit 7/2017 datë 2.2.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.
  - 7) Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mos përbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Koncesionarit për shkak të shkëljes së Kushteve të percaktuara në kontratën e koncesionit.
  - 8) Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, merr përsipër procedurën e shpronësimit për tokën prone private (nëse ka), e cila do të shfrytëzohet për ndërtimin e Hidrocentralit “Bushtrica 3”, me kusht që Koncesionari të përbushë të gjitha kërkesat ligjore për këtë shpronësim, si dhe të paguajë shpenzimet e shpronësimit.
  - 9) Autoriteti Kontraktues merr përsipër të mbështesë Koncesionarin për lidhjen e centralit me Rrjetin Elektrik Kombëtar, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 7/2017, datë 2.2.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

### **KREU III**

#### **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT**


##### **Neni 8**

##### **Detyrimet e Koncesionarit**

Koncesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës, konform termave dhe kushteve të saj.

- 1) Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, për miratim projektin e zbatimit, brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
- 2) Të marrë të gjitha lejet dhe licensat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3) Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontratës;



- 
- 4) Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
  - 5) Të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentralit, me fuqi totale të instaluar prej jo më pak se 6700 kW;
  - 6) Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;
  - 7) Të marrë masat e nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe rehabilitimin e çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga punimet e kryera gjatë ndërtimit dhe funksionimit të Hec "Bushtrica 3", për kthimin e tij, me shpenzimet e veta, në gjëndjen e mëparshme sipas detyrimeve të përcaktuara nga lejet përkatëse si dhe institucioneve të tjera vendimarrëse.
  - 8) Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.
  - 9) Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
  - 10) Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjënës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
  - 11) Koncesionari nuk duhet të ndërhyjë në burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës sipas miratimit të marrë nga institucioni përkatës;
  - 12) Koncesionari duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi për ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe të sasisë së ujit të përcaktuar si rrjedhë ekologjike në shtratin parësor të burimit ujor (lumit/përroit) në përputhje me rregullat ligjore në fuqi sipas miratimit të marrë nga institucioni përkatës;
  - 13) Koncesionari duhet të sigurojë ujin e nevojshëm për vaditje, në përputhje me nevojat e bujqësisë dhe legjislacionit në fuqi;
  - 14) Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
  - 15) Koncesionari ka të drejtë, kundrejt zgjedhjes së tij për shitjen e energjisë së pjesshme apo të plotë që i përket pjesës së tij të energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentrali.
  - 16) Në kuadër të zbatimit të punimeve për realizimin e projektit, bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndyshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, Koncesionari është i detyruar të emërojë një subjekt në rolin e mbikëqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
  - 17) Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

## **Neni 9**

### **Vlerësimi i Investimeve**

9.1. Mbi bazën e të dhënave të studimit të fizibilitetit, investimet që parashikohen të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 559,309,181.5 (pesëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e treqind e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një pike pesë) lekë pa TVSH, sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur.

9.2. Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit i cili mund të përmirësohet por duke ruajtur të pandryshuar termit e përcaktuara në këtë kontratë, (ose të ndryshuara me marrëveshje mes palëve)
- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës;

## **Neni 10**

### **Programi punimeve**

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve:

- 10.1. Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 ditësh nga data e pajisjes me të gjitha lejet e nevojshme për fillimin e punimeve të ndërtimit.
- 10.2. Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 24 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur. Afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës së Koncesionit.
- 10.3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt proceduriale për marrjen e tyre. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonesave të krijuara nga subjektet shtetërore.

## **Neni 11**

### **Testimi i veprës**

- 11.1. Në përfundim të punimeve, për të siguruar funksionimin e hidrocentralit, duhet të kryhet testimi i veprës dhe të nënshkruhet certifikata e pranimit të veprës nga Autoriteti Kontraktues, ose të autorizuarit prej tij. Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- 11.2. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues ose të autorizuarit prej tij dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit, brenda 30 ditëve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e veprës.
- 11.3. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

## **Neni 12**

### **Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit**

12.1. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën:

1. Kur Koncesionari nuk fillon punën për 1 muaj (për shkak të tij) nga data e marrjes së lejes së ndërtimit sipas pikës 10.1 të nenit 10. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.
2. Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktues;
3. Kur Koncesionari transferon aksionet/kuotat e veta tek të tretët, pa miratim të Autoritetit Kontraktues.
4. Kur Koncesionari braktis punimet e zbatimit për më shumë se 100 (njëqind) ditë të njëpasnjëshme. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e

Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14 si dhe “Hec Bushtrica 3” siç është në momentin e braktisjes, pa patur asnjë detyrim të çdo lloji karshi koncesionarit.

5. Kur Koncesionari është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi në paaftësi paguese ose situata të tjera të ngjashme, për faj të koncesionarit. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 14.
6. Kur Koncesionari nuk zbaton në mënyrë të përsëritur një/disa nga detyrimet e tij të parashikuara në këtë Kontratë.
7. Kur nuk siguron financimin e projektit brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës. Zgjidhja e njëanshme e kontratës, nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e detyrimeve që kanë të bëjnë me dorëzimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Palët bien dakord që dorëzimi do të bëhet brenda një afati kohor prej 60 ditësh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.

Nëse ky detyrim nuk përmbushet nga Koncesionari atëherë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e hidrocentraleve, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

#### 12.2. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Koncesionari:

Koncesionari, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë kur Autoriteti Kontraktues është në shkelje të detyrimeve të tij kontraktore dhe nuk e korrigjon këtë shkelje, brenda afatit të përcaktuar në pikën 12.4 të këtij neni.

#### 12.3. Zgjidhja e kontratës nga secila palë:

Secila nga palët ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

1. Me gjithë plotësimin e kriterëve nga ana e Koncesionarit për aplikim për leje, licenca në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ndërhyrjen e Autoritetit Kontraktues, koncesionari nuk është pajisur me to për arsye ligjore, për fillimin e punimeve dhe/ose operimin e Projektit.
2. Vazhdimi i saj bëhet i pamundur jo për faj të koncesionarit.
3. Në rastet e parashikuara nga neni 20, pika 20.4 e kësaj kontrate.
4. Kur ka shkelje serioze nga ana tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe mënyrës së parashikuar në kontratën e koncesionit.

#### 12.4. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- i. Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;
- ii. Datën e përfundimit të kontratës, në rast të mos korrigjimit të shkeljes brenda 30 ditëve nga data e njoftimit;
- iii. Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- iv. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

#### 12.5. Zgjidhja e kontratës me konsensus:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit të investimit. Gjithsesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës, me kusht që të ketë paguar kompensimin e rënë dakord me negocim midis dy palëve.

#### 12.6. Të Drejtat e Palëve Financuese dhe zëvendësimi i koncesionarit:

##### 12.6.1. Njoftimi i Palëve Financuese:

Menjëherë pas marrjes dijeni për shkelje serioze nga ana e koncesionarit të detyrimeve kontraktore, që çenojnë zbatimin dhe operimin e koncesionit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e kontratës sipas pikave 12.1.2, 12.1.3, 12.1.4, 12.1.5 e 12.1.6 të nenit 12 të kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues përveç njoftimit të koncesionarit sipas pikës 12.4 të këtij neni, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënien e një mundësie, kësaj të fundit, për të ndihmuar koncesionarin për të korigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e një njoftimi të tillë. Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

##### 12.6.2. Zëvendësimi i Koncesionarit

Në rast se pas ndihmës së ofruar nga Pala Financuese, nuk është bërë i mundur korigjimi i shkeljes nga koncesionari, Pala Financuese (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Koncesionarit në momentin e fitimit të garës;

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Kontraktuese.

Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra sigurorese mbi hidrocentralin.

12.6.3. Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vazhdimësinë e projektit, kontrata do të zgjidhet.

#### 12.7. Pagesat në rast zgjidhjeje të Kontratës:

##### 12.7.1. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Autoriteti Kontraktues për faj të koncesionarit.


Në rast të zgjidhjes së Kontratës për faj të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues konfiskon sigurimin e kontratës dhe nuk merr përsipër asnjë detyrim për pagesa ndaj Koncesionarit.

##### 12.7.2. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga Koncesionari për faj të Autoritetit Kontraktues.

Në rast të zgjidhjes së kontratës për faj të Autoritetit Kontraktues, ky i fundit duhet t'i paguajë koncesionarit, vlerën e investimit të kryer deri në momentin e zgjidhjes së kontratës minus vlerën e amortizimit të veprës, si dhe fitimin e munguar, që Koncesionari

mund të nxirte deri në përfundim të afatit të kësaj kontrate (35 vjet), siç llogaritet në paragrafin më poshtë:

**Fitimi i munguar** =  $(35 - \text{Numrin e viteve deri në datën e Zgjidhjes}) \times 0,6 \times (\text{Kthimi Mesatar mbi Kapitalin për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes}) \times (\text{vlera mesatare e Kapitalit të Vet për periudhën prej 3 vitesh të njëpasnjëshëm që i paraprin Zgjidhjes})$ .



#### 12.7.3. Pagesat e zgjidhjes së kontratës nga secila palë

Në rast zgjidhjeje të kontratës nga secila palë, sipas pikës 12.3.1 të këtij neni, Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim për pagesa ndaj koncesionarit.

### **Neni 13 Kontratat**

13.1. Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit, duke respektuar kufizimin e vendosur në pikën 17.2 të nenit 17 të kësaj kontrate. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate koncesioni.

Koncesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nën-kontraktuesin e propozuar:

- i. Emrin e tij dhe adresën;
- ii. Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
- iii. Vlerën e nënkontratës
- iv. Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

13.2. Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.

13.3. Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

### **Neni 14 Sigurimi i kontratës**

14.1. Koncesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, vlerën e Sigurimit të Kontratës prej 55,930,918.15 leke që përbën 10 % të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.

14.2. Koncesionarit i lejohet të ç'ngurtësojë 80% (tetëdhjetë %) të vlerës së sigurimit të kontratës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e nënshkrimit të certifikatës së pranimit të veprës nga Autoriteti Kontraktor, testimi dhe vënies në punë të saj sipas parashikimeve të nenit 11.

Ndërsa pjesën e mbetur prej 20% (njëzet %) të vlerës së sigurimit të kontratës do të ç'ngurtësohet në përfundim të periudhës së koncesionit, sipas nenit 4 të kësaj Kontrate.

14.3. Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe përfundimin e testimit.

### **Neni 15 Sigurimet**

15.1. Koncesionari në çdo kohë do të pajiset, mbajë dhe ripërtërijë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Koncesionare, dhe do t'i përcjellë, ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e certifikuara të çdo certifikate sigurimi pas marrjes së një njoftimi paraprak prej Autoritetit Kontraktues.

15.2. Koncesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas projektin e plotëgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara sipas Ligjit nr.52/2014 dt. 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit" gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.

15.1. Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë operimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguruesi do të paguajë për kompesimin e dëmit do të përballohet nga koncesionari.

15.2. Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

15.3. Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200,000 Euro për çdo ngjarje dhe 500,000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2,000 Euro në vit.

15.4. Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

### **Neni 16 Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit**

16.1. Tarifa koncesionare

Koncesionari duhet të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesionare të barabartë me vlerën e 2.1 % (dy pike një përqind) të prodhimit vjetor të energjisë elektrike, si dhe të çdo përfitimi tjetër që Koncesionari do të ketë, në raport të drejtë me përqindjen që përfaqëson tarifën koncesionare, nga prodhimi i kësaj energjie elektrike, duke përfshirë por pa u limituar në të drejtat që rrjedhin nga reduktimi i karbonit dhe gazrave të tjerë në atmosferë.

16.2. Vlera e riinvestimit

Duke filluar nga viti i 25-të nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë koncesionarit, kur është e nevojshme, të riinvestojë në makineritë e pajisjet e instaluara me qëllim dorëzimin e tyre në gjendje optimale pune në përfundim të periudhës së koncesionit dhe transferimit të veprës objekt koncesioni te ky i fundit. Ky riinvestim do të bëhet bazuar në praktikën e mirë industriale si dhe në përputhje me kartën teknologjike të makinerive dhe pajisjeve të instaluara, duke garantuar Autoritetin Kontraktor për mirëfunksionimin e veprës brenda parametrave teknike të parashikuar në kartat teknologjike të saj.

### **Neni 17 Kufizimet**

- 17.1.Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar tek të tretët, Koncesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast palës së tretë do ti transferohen dhe detyrimet apo të drejtat e përcaktuara në kontratën e koncesionit.
- 17.2.Koncesionari ka të drejtë të nënkontrakttojë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, në zbatim të nenit 34 të ligjit nr.125/2013, datë 25.04.2013 "Per koncesionet dhe partneritetin publik privat" të ndryshuar, duke lidhur kontrata që janë minimalisht 30 % e vlerës së kontratës së koncesionit te palët e treta, duke siguruar, në të njëjtën kohë, një mundësi të tenderuesit për ta rritur këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit.
- 17.3.Koncesionari ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese, me kusht që hipoteka, pengu apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit në këtë Kontratë dhe vetëm me miratimin me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 18 Raportimi**

Koncesionari është i detyruar që çdo 3 (tre) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 19 Legjislacioni i zbatueshëm**

Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.

### **Neni 20 Forca Madhore**

- 20.1."Forca madhore" nënkupton çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është absolutisht tej parashikimit dhe kontrollit, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të palës së cënuar që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të palës së cënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parashikuara në kontratë) të cilat mund të shkaktohen nga shprehjet e mëposhtme të "Forcës Madhore":

- 11  
10N
- a) kjo rrethanë në mënyrë objektive dhe absolute, nuk mund të parandalohej apo nuk ishte e mundur të parandalohej, shmangej ose mënjanohet nga pala e cënuar;
  - b) pala e cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e palës së cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;
  - c) ngjarja nuk është ose nuk ka qenë pasojë e drejtëpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga pala e cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate, dhe
  - d) pala e cënuar t'i ketë dhënë njoftim në afatin e rënë dakord palës tjetër (pala e pacënuar)

#### 20.2.Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore:

- a) Katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to;
- b) Lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo- që zgjasin për një kohë jo më të vogël se një muaj;

20.3.Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

Periodha e koncesionit do të zgjatet në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate.

#### 20.4.Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore

Pala e prekur nga forca madhore ka të drejtë të zgjidhë kontratën e koncesionit :

- a) në rast se edhe pas zbatimit të pikës 20.3 të këtij neni, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit,
- b) kur forca madhore zgjat më tepër se 6 muaj.

#### 20.5.Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore

Në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore, palët nuk kanë detyrime ndaj njera tjetrës dhe secila palë do të përballojë kostot e veta.

20.6.Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me nenin 22 të kësaj kontrate.

### Neni 21

#### Hyrja në fuqi e Kontratës së Koncesionit

Kontrata e Koncesionit do të hyjë në fuqi pasi të nënshkruhet nga palët, në përputhje me Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.



## Neni 22 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve



- 22.1. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
- 22.2. Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Gjykata kompetente për zgjidhjen e konflikteve administrative.
- 22.3. Fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

## Neni 23 Sanksionet

- 23.1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Koncesionarin si më poshtë:
  - a. Për shkelje të afatit të ndërtimit 0.05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara.
  - b. Për moskryerje në total të investimeve për vlerën e të cilës është rënë dakord sipas nenit 9.1, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të perealizuara.
  - c. Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve penalizohet me 10,000 lekë.
- 23.2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakord me këtë kontratë, penalizon Koncesionarin si më poshtë:
  - i. Në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 28 168 538 kWh/vit, Koncesionari penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese, duke patur parasysh se në këtë rast Autoriteti Kontraktues do ta marrë të plotë tarifën koncesionare prej 2.1 %. Në rast kur prodhimi nuk realizohet për shkaqe të tjera (jo për faj të koncesionarit), Koncesionari nuk penalizohet për prodhimin e munguar; ndërkaq, Koncesionari është i detyruar të paguajë tarifën koncesionare, në vlerën prej 2.1 % të prodhimit të realizuar.
  - ii. Për mosrealizim deri në 10% të fuqisë së vendosur, përcaktuar sipas nenit 3 të kësaj kontrate, Koncesionari penalizohet në shumën e llogaritur si më poshtë:

**Shuma e penalitetit** = Prodhimi vjetor i energjisë elektrike x Fuqia e painstaluar ( ne % )  
x Vitet e operimit si të llogaritura në ofertë x Çmimi i shitjes së energjisë elektrike vendosur nga ERE në momentin e kryerjes së testimit të veprës sipas nenit 11 të kësaj kontrate x FeeKoncesionare (ne %).

Ky penalitet do të aplikohet në momentin e testimit të veprës në përputhje me nenin 11 të kësaj kontrate.

- 23.3. Mosparaqitja në kohë e projektit të zbatimit për miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar në nenin 8, pika 1 të kësaj kontrate koncesionare, e penalizon Koncesionarin me 0.005% të vlerës së investimit për çdo ditë vonese.
- 23.4. Sanksionet paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 ditore lidhur me shkeljen.
- 23.5. Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditësh nga data e dhënies së njoftimit. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.
- 23.6. Aplikimi dhe pagimi i penaliteteve sipas këtij neni nuk e çliron koncesionarin nga përbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj kontrate.
- 23.7. Këto penalitete do të mbahen nga Sigurimi i Kontratës parashikuar në nenin 14 të kësaj Kontrate, duke patur parasysh se nëse vlera e këtij sigurimi nuk është mjaftueshme për shlyerjen e penaliteteteve, Koncesionari do ta plotësojë këtë shumë, rast pas rasti.

#### **Neni 24** **Rregullimi i shkeljeve**

- 24.1. Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 30 ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.
- 24.2. Kjo procedurë nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mos përbushja e detyrimeve.

#### **Neni 25** **Transferimi i Aseteve**

- 25.1. Me mbarimin e kontratës, Koncesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti Kontraktues, të asetëve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Koncesionari gjatë periudhës së koncesionit si dhe çdo titull mbi to, të zhveshura nga çdo lloj detyrimi, barre apo hipoteke.  
Proçesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit.
- 25.2. Koncesionari, duhet të transferojë pa kundërshtëpërblim në favor të Autoritetit Kontraktues:
- i. hidrocentralin dhe objektet ekzistuese të lidhura me të;
  - ii. ndërtesa, makineri, paisje;
  - iii. pronësinë mbi ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga ai;
  - iv. të drejtat kontraktore ;

*Bel*

vi. çdo të drejtë tjetër të fituar nga ai nëpërmjet kësaj kontrate;

25.3.Koncesionari, duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune, duke marrë parasysh normën e amortizimit përkatës.

Në rast se kontrata është zgjidhur për shkak të forcës madhore, koncesionari duhet të provojë se gjendja ekzistuese e aseteve ka ardhur si pasojë direkte e saj.

25.4.Çdo e drejtë që koncesionari ka fituar me këtë kontratë, do të mbarojë me transferimin e projektit.

25.5.Kostot e transferimit të projektit do të përballohen nga koncesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur për faj të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 26 Mbarimi i kontratës**

26.1.Kontrata koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet e nenit 4 të kësaj kontrate.

26.2.Mbarimi i kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

### **Neni 27 Konfidencialiteti**

Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ia bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

### **Neni 28 Ndryshime**

28.1.Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.

28.2.Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

### **Neni 29 Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit**

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari, janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo

ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjete) ditor nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkoet Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate. Adresat dhe numrat e kontaktit që do të perdoren gjatë zbatimit të kësaj kontrate janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Infrastruktues dhe Energjisë  
Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1001,  
Tiranë - Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria "Bushtrica Hydropower" sh.p.k.  
Adresa: Njesia administrative Nr.1, Rruga "Niko  
Avrami", Pasuria Nr.7/434+2-N, ZK 8120, Tirane,  
Shqipëri

**Neni 30**  
**Rregjistrimi i Kontratës**

Brenda 30 ditëve nga miratimi i projektit të zbatimit, kjo Kontratë duhet të rregjistrohet në rregjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kjo kontratë u hartua në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

**PALET**

**AUTORITETI KONTRAKTUES**

Ministria e Infrastruktues dhe Energjisë

Përfaqësuar nga :

Znj.Etleva Kondi

**KONCESIONARI**

Shoqëria "Bushtrica Hydropower" sh.p.k.

Përfaqësuar nga :

Z.Endrit Shabani










**Albsig**

Nr.Serie: 46455236

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

[Data]: **22.09.2017**

**Për:** [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]: **“ MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE ”**

**Bulevardi “ Deshmoret e Kombit ” Nr.1001, Tirane**

**Në emer të:** [Emri, adresa e ofertuesit të përcaktuar fitues]: **BUSHTRICA HYDROPOWER SHPK**  
**Nipt L72120013S**

**Procedura e prokurimit** [lloji i procedurës] : **E HAPUR**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** [objekti]: **“ DHENIE ME KONCENSION TE HIDROCENTRALIT BUSHTRICA 3”**

**Publikimi** [nëse zbatohet]: **Buletini i Njoftimeve Publike** [Data] [Numri]:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] **SHUSHICA HYDROPOWER SHPK** t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] **BUSHTRICA HYDROPOWER SHPK**, ka derdhur një depozitë pranë

**ALBSIG SH.A** në një shumë prej **Lek 68,040,000** ( Lek GjashtëDhjetë e TeteMilion e DyzetMije )

si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [emri i autoritetit kontraktor] **“ MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE ”**

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] **“ MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE ”** vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës, date 21.09.2019

**ALBSIG SH.A.**  
22.09.2017

## FORMULARI I OFERTËS



**Drejtuar:** Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë  
Blvd Dëshmorët e Kombit nr.1001, Tirane

**Lënda :** Oferta e bashkimit të përkohshëm të shoqërive ENOLIO Sh.p.k, EL-BU 2009 Sh.p.k dhe VEGA Sh.p.k, për procedurën konkurruese "Dhënie me koncesion të Hidrocentralit Bushtrica 3".

**Date :** 12.06 .2017

Forma e paraqitjes së ofertës përcaktohet si më poshtë:

Nr.	Kriteret	Njësia matëse	Oferta ose Referencën në Ofertën Tuaj
1	Fuqia e instaluar e përcaktuar me prurjen llogaritëse	KW	<b>6700</b>
2	Vlera e "Fee koncesionare" (e shprehur në % të energjisë elektrike vjetore të prodhuar)	%	<b>2.1</b>
3	Analiza ekonomike dhe financiare		Studimi "Plani i Biznesit dhe Analiza Ekonomike"
4	Kapaciteti financiar		<b>Dokumentat Bankar</b>
5	Ndikimi ekologjik dhe social		Studimi i "Vleresimit të Ndikimit në Mjedisin ekologjik dhe social"
6	Skema e lidhjes së centralit me sistemin elektroenergjitik		Studimi i "Lidhjes me Sistemin Elektro Energjitik"
7	Koha e zbatimit të punimeve	Muaj	<b>24</b>
8	Kosto për njësi të makineri dhe pajisje dhe teknologjia e tyre	Lekë/KW	<b>68,100.00</b>

Vlera e Investimit (pa TVSH): **559,309,181.5 Lekë**

Perfaqësuesi i Bashkimit të operatorëve

**EL-BU 2009**


**Edison Allmuça**

*(Handwritten signature)*

**PREVENTIV  
NDERTIMI I HIDROCENTRALIT BUSHTRICA 3**



Nr. analizes	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Çmimet njësi Lekë	Vlera në Lekë	Vlera në Euro
<b>I. PUNIME NDERTIMI</b>						
<b>1-Vepra e Marrjes V.M.1</b>						
3	Skarifikime (hapje sheshi).	m2	700.00	50.00	35,000.00	257.35
3.90/a	Germim shkembim me matrapik me Eskavator me zinxhira	m3	100.00	1,100.00	110,000.00	808.82
3.122/a	Germim dheu	m3	200.00	400.00	80,000.00	588.24
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m3	300.00	400.00	120,000.00	882.35
3.245/an	Beton C25/30 shpatullat +muret	m3	40.00	13,500.00	540,000.00	3,970.59
3.245/an	Beton C25/30 per pjesen qendrore	m3	30.00	13,500.00	405,000.00	2,977.94
3.244/an	Beton C20/25 per pjesen qendrore	m3	30.00	13,500.00	405,000.00	2,977.94
3	Mure gabion (mbrojtjes+shtrese) gurc	m3	25.00	5,500.00	137,500.00	1,011.03
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	4.00	110,000.00	440,000.00	3,235.29
3.288	F.V Zgare metalike	Ton	1.00	115,000.00	115,000.00	845.59
3.644	F.V. Porta të sheshta manovrimi	Ton	1.00	280,000.00	280,000.00	2,058.82
2.360	Ngjeshje dheu+zhavorri	m3	60.00	350.00	21,000.00	154.41
	<b>SHUMA 1</b>				<b>2,688,500.00</b>	<b>19,768.38</b>
<b>2- Kanali reakordimit nga V.M.1 ne Dekantuesin I, L=15ml</b>						
3.90/a	Germim shkembim me matrapik me Eskavator me zinxhira	m3	8.00	1,100.00	8,800.00	64.7
3.122/a	Germim dheu	m3	120.00	400.00	48,000.00	352.9
3.183/a	Shtrese zhavorri, t=10cm	m3	2.00	2,500.00	5,000.00	36.8
3.245	Beton C25/30 per bazamentin	m3	2.30	14,000.00	32,200.00	236.8
3.245	Beton C25/30 per muret anesore	m3	2.40	14,000.00	33,600.00	247.1
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	0.20	110,000.00	22,000.00	161.8
2.36	Mbushje dhe Ngjeshje dheu + zhavorri	m3	6.00	350.00	2,100.00	15.4
	<b>SHUMA 2</b>				<b>151,700.00</b>	<b>1,115.4</b>
<b>3-Dekantuesi 1</b>						
3.90/a	Germim dheu+shkembim	m3	320.00	1,100.00	352,000.00	2,588.2
3.122/a	Germim dheu	m3	160.00	400.00	64,000.00	470.6
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m3	160.00	400.00	64,000.00	470.6
3.183/a	Shtrese zhavorri, t=10cm	m3	13.00	2,500.00	32,500.00	239.0
3.245	Beton C25/30 per bazamentin	m3	40.00	13,500.00	540,000.00	3,970.6
3.245	Beton C25/30 per bazen ,pjesa e hyrjes	m3	30.00	13,500.00	405,000.00	2,977.9
3.245	Beton C25/30 per bazen ,pjesa e daljes	m3	20.00	13,500.00	270,000.00	1,985.3
3.245	Beton C25/30 per muret anesore	m3	20.00	13,500.00	270,000.00	1,985.3
	F V Tub Çeliku. DN=500mm	Ton	0.80	105,000.00	84,000.00	617.6
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	4.00	110,000.00	440,000.00	3,235.3
3.644	Porta metalike	Ton	1.00	200,000.00	200,000.00	1,470.6
2.36	Mbushje dhe Ngjeshje dheu + zhavorri	m3	20.00	350.00	7,000.00	51.5
	<b>SHUMA 3</b>				<b>2,728,500.00</b>	<b>20,062.5</b>
<b>4-Kanali i derivacionit pa presion nga Dekantuesi 1 në Basenin e Presionit, I=3200ml</b>						
3.3	Skarifikim per hapje traseje te kanalit	m2	10,000.00	50.00	500,000.00	3,676.5
3.122/a	Germim dheu	m3	13,040.00	400.00	5,216,000.00	38,352.9
3.90/a	Germim shkembim me matrapik me Eskavator me zinxhira	m3	10,800.00	1,100.00	11,880,000.00	87,352.9
3.183/a	Shtrese zhavorri, t=10cm	m3	200.00	2,500.00	500,000.00	3,676.5
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m3	2,100.00	400.00	840,000.00	6,176.5
3.245	Bazament+mure b/arne C20/25 (kanal derivacioni, I=3200ml)	m3	900.00	13,500.00	12,150,000.00	89,338.2
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	18.00	110,000.00	1,980,000.00	14,558.8
2.36	Mbushje dhe Ngjeshje dheu	m3	1,800.00	350.00	630,000.00	4,632.4
	<b>SHUMA 4</b>				<b>33,696,000.00</b>	<b>247,764.7</b>



5-Veprat e Marrjes V.M.2						
3.30	Skarifikime (hapje sheshi)	m2	250.00	50.00	12,500.00	91.91
3.90/a	Gërmim shkëmbi me matrapik me Eskavator me zinxhira	m3	80.00	1,100.00	88,000.00	647.06
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m3	50.00	400.00	20,000.00	147.06
3.245/an	Beton C25/30 shpatullat +muret	m3	20.00	13,500.00	270,000.00	1,085.29
3.245/an	Beton C25/30 per pjesen qendrore	m3	10.00	13,500.00	135,000.00	992.65
3.244/an	Beton C20/25 per pjesen qendrore	m3	15.00	13,500.00	202,500.00	1,488.97
3.33	Mure gabion (mbrojtjes+shterese) gure	m3	10.00	5,500.00	55,000.00	404.41
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	ton	2.25	110,000.00	247,500.00	1,819.85
3.29	F.V Zgare metalike	ton	0.50	115,000.00	57,500.00	422.79
2.36	Ngjeshje dheu + zhavorri	m3	25.00	350.00	8,750.00	64.34
<b>SHUMA 5</b>					<b>1,096,750.00</b>	<b>8,064.34</b>
6- Kanali reaktordimit nga V.M.2 ne Dekantuesin 2, L=8ml						
3.90/a	Gërmim shkëmbi me matrapik me Eskavator me zinxhira	m3	25.00	1,100.00	27,500.00	202.2
3.122/a	Gërmim dheu	m3	30.00	400.00	12,000.00	88.2
3.183/a	Shtrese zhavorri, t=10cm	m3	2.00	2,500.00	5,000.00	36.8
3.245	Beton C25/30 per bazamentin	m3	2.30	13,500.00	31,050.00	228.3
3.245	Beton C25/30 per muret anesore	m3	2.40	14,000.00	33,600.00	247.1
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	0.40	110,000.00	44,000.00	323.5
2.36	Mbushje dhe Ngjeshje dheu + zhavorri	m3	8.00	350.00	2,800.00	20.6
<b>SHUMA 6</b>					<b>155,950.00</b>	<b>1,146.7</b>
7-Dekantuesi 2						
3.90/a	Gërmim shkëmbi me matrapik me Eskavator me zinxhira	m3	50.00	1,100.00	55,000.00	404.4
3.122/a	Gërmim dheu	m3	110.00	400.00	44,000.00	323.5
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m3	50.00	400.00	20,000.00	147.1
3.183/a	Shtrese zhavorri, t=10cm	m3	5.00	2,500.00	12,500.00	91.9
3.245	Beton C25/30 per bazamentin	m3	15.00	13,500.00	202,500.00	1,489.0
3.245	Beton C25/30 per bazen pjesa e hyrjes	m3	10.00	13,500.00	135,000.00	992.6
3.245	Beton C25/30 per bazen pjesa e daljes	m3	10.00	13,500.00	135,000.00	992.6
3.245	Beton C25/30 per muret anesore	m3	15.00	13,500.00	202,500.00	1,489.0
	F V Tub Çeliku. DN=500mm për shpëlarjen e tij	Ton	0.30	115,000.00	34,500.00	253.7
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	2.50	110,000.00	275,000.00	2,022.1
3.644	Porta metalike	Ton	1.30	200,000.00	260,000.00	1,911.8
2.36	Mbushje dhe Ngjeshje dheu + zhavorri	m3	20.00	350.00	7,000.00	51.5
<b>SHUMA 7</b>					<b>1,383,000.00</b>	<b>10,169.1</b>
8-Kanali i derivacionit pa presion nga Dekantuesi 2 në Basenin e Presionit, L=430ml						
3.3	Skarifikim per hapje traseje te kanalit	m2	900.00	50.00	45,000.00	330.9
3.122/a	Gërmim dheu me eskavator me zinxhira	m3	1,300.00	400.00	520,000.00	3,823.5
3.90/a	Gërmim shkëmbi me matrapik me Eskavator me zinxhira	m3	2,200.00	1,100.00	2,420,000.00	17,794.1
3.183/a	Shtrese zhavorri, t=10cm	m3	60.00	2,500.00	150,000.00	1,102.9
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m3	500.00	400.00	200,000.00	1,470.6
3.245	Bazament+mure b/arne C20/25 (kanal derivacioni, L=3200ml)	m3	150.00	13,500.00	2,025,000.00	14,889.7
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	10.50	110,000.00	1,155,000.00	8,492.6
2.36	Mbushje dhe Ngjeshje dheu	m3	300.00	350.00	105,000.00	772.1
<b>SHUMA 8</b>					<b>6,620,000.00</b>	<b>48,676.5</b>
9-Baseni i Presionit.						
3	Skarifikim per hapje traseje te tubacionit	m2	400.00	50.00	20,000.00	147.1
3.90/a	Gërmim dheu+shkëmbi	m3	260.00	1,100.00	286,000.00	2,102.9
3.122/a	Gërmim dheu	m3	100.00	400.00	40,000.00	294.1
3.158/5a	Transporti dheu me auto deri 5 km	m3	250.00	400.00	150,000.00	1,102.9
3.183/a	Shtrese zhavorri natyrale, t= 10cm	m3	30.00	2,500.00	75,000.00	551.5
3.245	Beton C25/30 per bazament+mure	m3	120.00	13,500.00	1,620,000.00	11,911.8
2.11	Beton shtrese M-100	m3	6.00	9,000.00	54,000.00	397.1
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	9.60	110,000.00	1,056,000.00	7,764.7
3.288	F V Zgare metalike	ton	2.00	140,000.00	280,000.00	2,058.8
2.360	Mbushje dhe Ngjeshje dheu + zhavorri	m3	150.00	350.00	52,500.00	386.0
3.644	F.V Porta metalike	Ton	1.20	200,000.00	240,000.00	1,764.7
<b>SHUMA 9</b>					<b>3,873,500.00</b>	<b>28,481.6</b>



10-Tubacionet e renies se turbinave, Ø 1520mm, L=1170ml						
3.30	Skarifikime per trasene e T. Presionit	m2	1,100.00	100.00	1,200,000.00	808.8
3.90/a	Germim shkambi	m3	1,200.00	1,100.00	1,320,000.00	9,705.9
3.122/a	Germim dheu	m3	3,000.00	400.00	1,200,000.00	8,823.5
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m3	2,200.00	400.00	880,000.00	6,470.6
3.244	Beton C20/25 per ankerat	m3	200.00	13,500.00	2,700,000.00	19,852.9
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	14.00	110,000.00	1,540,000.00	11,323.5
	F.V tub Çeliku Ø1520 mm, δ= 8mm (600m), 9mm (300m) & 12mm (270m)	Ton	105.00	105,000.00	11,025,000.00	81,066.2
2.360	Mbushje dhe Ngjeshje dheu + zhavori	m3	3,500.00	350.00	1,225,000.00	9,007.4
	<b>SHUMA 10</b>				<b>20,000,000.00</b>	<b>147,058.8</b>
11-Tubacioni i Shkarkimit nga baseni						
3	Skarifikime per trasene e T. Presionit	m2	125.00	50.00	6,250.00	46.0
3.90/a	Germim shkambi	m3	50.00	1,100.00	55,000.00	404.4
3.122/a	Germim dheu	m3	60.00	400.00	24,000.00	176.5
3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5 km	m3	50.00	400.00	20,000.00	147.1
	F.V tub Çeliku Ø508mm (δ=6.3mm), L=100ml	Ton	2.00	105,000.00	210,000.00	1,544.1
3.244	Beton C20/25 per pus shuarje	m3	5.00	14,000.00	70,000.00	514.7
3.289/an	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	0.35	110,000.00	38,500.00	283.1
2.36	Mbushje dhe Ngjeshje dheu + zhavori	m3	60.00	350.00	21,000.00	154.4
	<b>SHUMA 11</b>				<b>444,750.00</b>	<b>3,270.2</b>
12-Ndertesa e hidrocentralit						
3.3	Skarifikim dheu	m2	310.00	50.00	15,500.00	114.0
3.122/a	Germim dheu	m3	530.00	400.00	212,000.00	1,558.8
3.90/a	Germim shkambi	m3	200.00	1,100.00	220,000.00	1,617.6
3.183/a	Shtrese zhavori , t=10ccm	m3	20.00	2,500.00	50,000.00	367.6
3.245	Beton M-250 bazament + mure	m3	150.00	13,500.00	2,025,000.00	14,889.7
3.245	Beton M-250 shkaile	m3	2.60	13,500.00	27,000.00	198.5
3.245	Kolona Beton M-250	m3	18.00	11,000.00	198,000.00	1,455.9
3.245	Kolona te vogla Beton M-250	m3	2.50	13,500.00	33,750.00	248.2
3.242	(Kanalet e shkarkimit) Beton M-250	m3	15.00	13,500.00	202,500.00	1,489.0
3.288	F V Hekur betoni SN-500N/mm2	Ton	9.38	110,000.00	1,031,250.00	7,582.7
2.383	F.V. Dyer per Godinen	m2	22.00	9,000.00	198,000.00	1,455.9
3.7	F.V. Dritare per Godinen	m2	18.00	9,000.00	162,000.00	1,191.2
2.331	Suvatime me llac cemento	m2	520.00	850.00	442,000.00	3,250.0
2.111/2	Mure mbrojtjes per godinen M-200	m3	25.00	12,000.00	300,000.00	2,205.9
2.64	Mure tuile	m3	55.00	10,000.00	550,000.00	4,044.1
2.218	Mbulese	m2	200.00	5,000.00	1,000,000.00	7,352.9
an	F.V. Shina per Vincuren	m1	40.00	16,000.00	640,000.00	4,705.9
an	Vine ure 10 ton (per hidroagregatin)	cope	1.00	800,000.00	800,000.00	5,882.4
2.266/1	Shtrese me pllaka	m2	140.00	2,500.00	350,000.00	2,573.5
2.36	Ngjeshje dheu	m3	40.00	350.00	14,000.00	102.9
	<b>SHUMA 12</b>				<b>8,471,000.00</b>	<b>62,286.8</b>
13- Hapje Rrugësh aksesi dhe shërbimi						
	Hapje Rrugësh aksesi dhe shërbimi	Leke	1.00	1,000,000.00	1,000,000.00	7,352.9
	<b>SHUMA 13</b>				<b>1,000,000.00</b>	<b>7,352.9</b>
14- Shpronësime për objektin						
	Shpronësime për objektin	Leke	1.00	1,000,000.00	1,000,000.00	7,352.9
	<b>SHUMA 14</b>				<b>1,000,000.00</b>	<b>7,352.9</b>
	<b>SHUMA E PUNIMEVE TE NDERTIMIT (1 - 14)</b>				<b>83,309,650.0</b>	<b>612,571.0</b>
	<b>SHPENZIME NGRITJE KANTIERI 2% E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT</b>			0.02	1,249,644.8	9,188.6
				Shuma	84,559,294.8	621,759.5
	<b>FONDI REZERVE 5% E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT</b>			0.05	4,227,964.7	31,088.0
	<b>SHUMA TOTALE E PUNIMEVE TE NDERTIMIT</b>				<b>88,787,259.49</b>	<b>652,847.5</b>

<b>II. PUNIME TE TJERA</b>						
<b>15--Lidhja me N/st Prrrenjas 110/35/6 kV, Linje 35kV - 8km</b>						
1	F.V. shlytje metalike (komplet me bazament)	copë	26	200,000.00	5,300,000.00	38,235.29
2	F.V. perçjetës Ai-Ç - 50 mm <sup>2</sup>	kg	1,104	150.00	1,656,000.00	14,911.76
3	F.V. OPGW 25 mm <sup>2</sup>	kg	800	450.00	360,000.00	2,647.06
4	F.V. Elektroda tokzimi	copë	78	2,800.00	218,400.00	1,605.88
5	F.V. shirit tokzimi 40 x 4 mm	ml	130	700.00	91,000.00	669.12
6	F.V. Shkarkues 35 kV	copë	6	15,000.00	90,000.00	661.76
7	F.V. Transformator rryme 35 kV - 100/5A	copë	6	200,000.00	1,200,000.00	8,823.53
8	F.V. Transformator tensioni 35/0,1 kV	copë	2	200,000.00	400,000.00	2,941.18
9	F.V. Mates energjie aktive/reaktive 100V/5A	copë	1	180,000.00	180,000.00	1,323.53
10	Trakt hyrje ne N/Stacion (komplet) 35kV	copë	2	1,050,000.00	2,100,000.00	15,441.18
11	Transport	copë	1	950,000.00	950,000.00	6,985.29
	Shuma 10/1				12,817,400.00	94,245.59
	Fondi Reserve (~3%)				384,522.00	2,827.37
	<b>SHUMA 15</b>				<b>13,201,922.00</b>	<b>97,072.96</b>
<b>16-Mjedisi</b>						
an	Mbjellje pemesh	copë	1,200.00	500.00	600,000.00	4,411.8
an	Sisteme skarpatash	m <sup>2</sup>	1,500.00	300.00	450,000.00	3,308.8
	<b>SHUMA 11</b>				<b>1,050,000.00</b>	<b>7,720.6</b>
<b>17-Makineri pajisje teknologjike</b>						
an	Makineri pajisje hidromekanike dhe elektrike (turbine, pancleelektrike, n/st elektrik, etj)	kW	6,700.00	68,100.00	456,270,000.00	3,354,926.5
	<b>SHUMA 17</b>				<b>456,270,000.00</b>	<b>3,354,926.5</b>
	<b>SHUMA 15-17 PUNIMEVE TE TJERA</b>				<b>470,521,922.00</b>	<b>3,459,720.0</b>
	<b>TOTALI I PREVENTIVIT HEC BUSHTRICA 3 (PA TVSH)</b>				<b>559,309,181.5</b>	<b>4,112,567.51</b>





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E KONCESIONEVE, PROKURIMEVE  
SHPRONËSIMEVE DHE PRIVATIZIMIT

Nr. 4452/ Prot.  
15

Tiranë, më 13 / 9 / 2017

**AUTORIZIM**

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë”, Titulli II, kreu I, (përfaqësimi), Ligjit nr. 125/2013 “Për partneritetin publik privat”, i ndryshuar, autorizoj Znj. Etleva Kondi, Drejtore e Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit, të nënshkruajë Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim – Operim - Transferim) “Për ndërtimin e hidrocentralit Bushtrica 3”.

MINISTRI

  
DAMIAN GJIKNURI

Erudite Graham G.